

V E N D I M
Nr.14, datë 24.1.1994

PËR NDRYSHIMIN E VENDBANIMIT NGA SHTETASIT SHQIPTARË

Në mbështetje të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993: “Për një shtesë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dizpozitat kryesore kushtetuese”, dhe të ligjit nr.584O, datë 20.2.1979:”Për regjistrimin e akteve të gjendjes civile”, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Shtetasit shqiptarë janë të lirë të zgjedhin vendbanimin e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Për lëvizjen e evidencës së gjendjes civile shtetasi paraqet në zyrën përkatëse të vetbanimit të ri (bashki, komunë) një kërkesë me shkrim dhe sipas rastit dokumentin e pronësisë së banesës ku është vendosur, kopjen e kontratës së qiramarrjes së banesës dhe çdo dokument tjetër që vërteton qëndrimin e tij në një banesë të caktuar të ndërtuar në mënyrë të ligjshme, të vërtetuar nga kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes ose kryetari i bashkisë a komunës në qytetet që nuk kanë lagje.

Zyra e gjendjes civile e vendbanimit të ri i kërkon zyrës së gjendjes civile të vendbanimit të mëparshëm të bëjë çregjistrimin nga refjistri themeltar dhe të dërgojë dokumentet përkatëse për të bërë regjistrimin në vetbanimin e ri.

3. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.361, datë 1.11.1977 “Për lejet e banimit të shtetasve”, nr.359, datë 25.9.1987 “Për shqyrtimin e kërkesave të shtetasve që lëvizin jashtë fshatit të bashkuar ose rrethit”, dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi